



Dr. Christoph Eymann
Vorsteher des Erziehungs-
departements Basel-Stadt



Peter Malama
Direktor des Gewerbe-
verbandes Basel-Stadt

Ju urojmë mirësearchje të përzemërt në panairin e formimit profesional dhe arsimor të Bazelit

Të dashur prindër të fëmijëve që kanë mbaruar shkollimin e obligueshëm!

Ekonomia zvicerane është mirë. Ndërmarrjet tona janë të suksesshme në mbarë botën. Për këtë ato kanë nevojë për bashkëpunëtorë dhe bashkëpunëtorë me formim të mirë arsimor. Se prej nga e kanë prejardhjen nuk është e rëndësishme. Portugez apo zviceran, turk apo kroat: Kush posedon një arsimim solid dhe shfrytëzon atë në punë kontribuon në suksesin e industrisë dhe ekonomisë zvicerane dhe ka gjithashtu edhe përfitime vetjake.

Tani parashtroji sigurisht pyetjen, se si është e mundur që nxënëset dhe nxënësit me emra që tingëllojnë të huaj kanë akoma probleme më shumë për të gjetur tek ne një vend për mësimin e një profesioni se sa vendasit e ri? Dhe përse një e treta e të rinjve të huaj në Zvicër pas mbarimit të shkollimit të obligueshëm nuk e vazhdon shkollimin? As ne nuk i dimë të gjitha përgjigjet e këtyre pyetjeve. Por ne dëshirojmë që kjo gjë të ndryshon!

Mësimi i një profesioni me formim profesional është për shumë njerëz të ri shtegu më i përshtatshëm për në tregun e punës. Kush ka një vend pune dhe një punë të kënaqshme e ndien veten mirë dhe pranohet më lehtë edhe në shoqëri. Sa më mirë që të formohen nxënëset dhe nxënësit që kanë mbaruar shkollimin e obligueshëm aq më i vogël është rreziku që mos të gjejnë një vend pune dhe dikur të jenë të varur nga ndihma sociale.

Nëse keni fëmijë të vegjël, të cilët në të ardhmen e afërt mbarojnë shkollimin e obligueshëm dhe qëndrojnë para zgjedhjes së profesionit, atëherë nuk guxoni të mungoni në panairin e tretë të formimit profesional dhe arsimor në Bazel! Nga 14 deri më 16 tetor 2010 në qendrën e paniaive në Bazel ne ju shpjegojmë funksionimin e sistemit shkollor në Zvicër. Ne ju informojmë mbi mundësitë e ndryshme të formimit profesional që kanë fëmijët tuaj, dhe atë në njëmbëdhjetë gjuhë të ndryshme. Merreni çupat e çunat me vete ngase ne ju tregojmë mbi 250 shtigje të mundshme në botën profesionale. Dhe profesionistët nga praktika kanë përgjigjet në pyetjet tuaja, si: «Si dhe ku mund të gjejë një vend për mësimin e një profesioni?», «Çka bëjë pas mësimin të profesionit?», «Si mund të arsimohem më tej pas mësimin të profesionit?», «Cilën shkollë profesionale do të vijoj?» apo «Sa do të fitoj?».

Pra ju urojmë mirësearchje të përzemërt – ne ndiejmë kënaqësi për vizitën tuaj!

Dr. Christoph Eymann

Peter Malama